



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2021

VENDIM

Nr. 328, datë 22.07.2021

**PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 90/3 e 94/1 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 171/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR ELBASAN

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, Emona Muçi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, çështjen gjyqësore me Padi të: {...} (trashëgimtarët e tij); Të paditur: {...}, etj.; Objekti: “Njohje pavërtetësi dokumenti, etj.”

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, Artur Prenga, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, çështjen gjyqësore me Kërkuese: {...}; Objekti: “Rishikim vendimi”.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, Luljeta Kolonja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, çështjen gjyqësore me Padi të: {...}; E paditur: {...}; Objekti: “Shpërblim dëmi”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR GJIROKASTËR

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, Yrfet Shkreli, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}; Objekti: “Rivendosje në afat”; Akuza: “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, parashikuar nga nenet 79/dh dhe 278/1 i Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR SARANDË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, Gjergji Baçi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}; Akuza: “Trafikimi i narkotikëve”, mbetur në tentativë, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/a në lidhje me nenin 22 të Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR PËRMET

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, Alban Veçani (relator), Suela Xhani dhe Fatmir Ndreu, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet; Të pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal; “Organizimi ose ushtrimi i veprimtarive të lojrave të fatit në kundërshtim me ligjin”, parashikuar nga neni 197/1 i Kodit Penal”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Blerta Marku (Çibuku), caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria Përmet; Objekti: “Rishqyrtim mase mjekësore për shtetasin {...}”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KUKËS

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Aulon Pashaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}, {...}; Akuza: “Prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR PUKË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Sokol Shehu, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pukë; I pandehur: {...}; Objekt: “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Hasan Selimi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pukë; Të pandehur: {...}, {...}, {...}Objekt: “Mospagimi i tatimeve dhe taksave”, parashikuar nga neni 181 i Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LEZHË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, Flutura Hoxha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, çështjen gjyqësore me Paditës: {...}, {...}, {...}, {...}; E paditur: {...}; Objekti: “Zgjidhjen e kontratës së shitblerjes nr.2328 rep, nr.933 kol, datë 30.10.2013 ndërmjet palëve {...}, {...}dhe {...}. Zgjidhjen e kontratës së shitblerjes nr.2325 rep, nr.931 kol, datë 30.10.2013 ndërmjet palëve {...}, {...}dhe shoqëria “{...}, etj.”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, Flutura Hoxha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}, {...}; Akuza: “Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KRUIJË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Alda Sadiku, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}; Akuza: “Kanosje për shkak të detyrës”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 238-25 i Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR MAT

Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës nr.547 prot., datë 16.07.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, për caktimin e një gjyqtari, në çështjen penale, si vijon:

1. Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Mat; të pandehur: {...}, etj.; akuza: “Nenet 284/2 dhe 283/2 të Kodit Penal”.

GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, Emona Muçi si dhe gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Irida Kacerja, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Nenet 298/3, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal”.

GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, Margarita Buhali dhe Laurent Fuçia, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjyrokastër, çështjen gjyqësore me Paditës: Këshilli i Ministrave; Të paditur: {...}, {...}, etj.; Objekti: “Njohje pronar të shtetit shqiptar, etj.”

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, Engert Pëllumbi dhe Nazmi Troka, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}, {...}, {...}, etj.; Akuza: “Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Skënder Damini, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}; Akuza: “Dhuna në familje”.

GJYKATA E APELIT KORÇË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Elbana Lluri, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}; Akuza: “Ngacim seksual”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Edlira Petri, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}; Akuza: “Dhunë në familje”; “Shkatërrim i pronës” dhe “Largim i të burgosurit nga vendi i qëndrimit”.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Ridvan Hado, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: “Shfuqizimi i masës disiplinore nr.1068/5, datë 03.04.2020 të Komisionit të IEVP Korçë, për shkelje “Përdorim i fjalëve të pahijshme dhe fyese ndaj personave të tjerë”; Objekti i shqyrtimit: “Kërkesa për përjashtim gjyqtari”.

4. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, Valdete Hoxha dhe Ridvan Hado, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}; Akuza: “Dhunë në familje”.

5. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, Genti Shala dhe Valdete Hoxha, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}; Akuza: “Dhunë në familje”.

6. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Genti Shala, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me Ankues: {...}; Objekti: “Kundër vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal nr. {...}, viti 2019, datë 21.12.2019, etj.”.

7. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Elona Toro, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}, {...}, etj.; Akuza: “Trafikim i narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë”.

GJYKATA E APELIT SHKODËR

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Durrës, Anita Mici, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen gjyqësore me Padi të: {...}; E paditur: {...}, {...}; Objekt: “Vërtetim fakti juridik”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Durrës, Igerta Hysi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}; Objekti: “Shuarje dënimi”.

GJYKATA E APELIT TIRANË

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Korçë, Sonjela Voskopi dhe Dritan Hasani, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Tiranë, çështjen gjyqësore me Padi të: Shoqëria “{...}”; E paditur: Shoqëria përmbarimore “{...}”; Objekti: “Pavlefshmëri titulli ekzekutiv”.

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Korçë, Sonjela Voskopi (relatore), Dritan Hasani dhe Arta Duka, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Tiranë, çështjen gjyqësore me Kërkuese: {...}; Palë e tretë: {...}; Objekt: “Ndreqje gabimi”.

GJYKATA E APELIT VLORË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Irena Brahimi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Padi të: {...}; I paditur: {...}; Objekti: “Zgjidhje martese. Përcaktim i përgjegjësive prindërore. Përcaktim i detyrimit i detyrimit ushqimor”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Sokol Pina, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Kërkuese: Prokuroria Fier; Të pandehur: {...}, {...}, {...}; Akuza: “Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 e 25 i Kodit Penal”.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Korçë, Arta Duka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Apelit, çështjen civile me Padi të: {...}; I paditur: Këshilli i Emërimeve në Drejtësi; Objekti: “Shfuqizimi si i papajtueshëm më ligjin i

vendimit nr.4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuesëve dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Korçë, Dritan Hasani, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Apelit, çështjen civile me Paditës: {...} etj; Të paditur: {...}; Objekt: “Marrjen e masës së sigurimit. Konstatim i pavlefshmërisë absolute të Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr. {...}, datë 18.12.1998, etj.”

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR